



17/10 K.S.U
25.10.24

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR ERZEN

V E N D I M

Nr.11 , datë 16/10/2024

PËR

**REFUZIMIN E KËRKESËS “PËR MIRATIMIN E AUTORIZIMIT
PËR PËRDORIM BURIMI UJOR SIPËRFAQËSOR PËR
TURIZËM, ARGËTIM, LUNDRIM SUBJEKTIT “ST.LUIS
WATERSPORT”**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, VKM-së nr. 696, datë 30.10.2019 “Për përcaktimin e kufijve territorialë, hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe të qendrës e përbërjes së Këshillit të secilit prej tyre”, VKM-së nr.550, datë 15.7.2020 “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, Këshilli i Basenit Ujor Erzen,

KONSTATOI SE:

Pas shqyrtimit të kërkesës së subjektit “St.Luis Watersports” shpk “Kërkesë për autorizim për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për turizëm, argëtim, lundrim për argëtim”, me vendndodhje: Deti Adriatik, Plazhi Rrazhbullit, Bashkia Durrës, rezultoi se:

1. Bashkia Durrës nëpërmjet shkresë me nr.11771/1 prot., datë 15.10.2024 nuk është dakord për dhënien e kësaj leje pasi për arsye se koordinatat e këtij projekti mbivendosen sipër koordinatave të vendbazimit të miratuar në hartën e përgjithshme të plazheve të lejuara duke sjellë një cenim të kushteve të sigurisë;

2. Bashkia Durrës nga komunikimi nëpërmjet postës elektronike me Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, ju është bërë e ditur që subjekti e ka përfituar kontratën 1 vjecare për parcelat DR-773 dhe DR-774 në bazë të aplikimit si një strukturë shërbimi të ndodhur në plazhin e Rrashbullit;
3. Nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit se ky subjekt nuk disponon nga ky institucion certifikatë kategorizimi si strukturë akomoduese, për këtë arsye për sezonin turistik 2025 ky subjekt nuk mund të ushtrojë veprimtarinë e stacion plazhi dhe për rrjedhojë duke mos patur kontratë nuk mund të qëndrojë autorizimi që kërkon të pajiset;
4. Nuk mund të mbivendosen aktivitetet, pasi subjekti zhvillon edhe aktivitetin e mjeteve të lundrimit, por pa lejen përkatëse nga organet e menaxhimit të burimeve ujore;

PËR KËTO ARSYE:

Këshilli i Basenit Ujor Erzen bazuar në gërmën (ç), të pikës 14, të Kreut IV, të VKM-së nr.550, datë 15.07.2020, dhe në vendimin nr.6, datë 12.06.2019, “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Basenit Ujor”, të Këshillit Kombëtar të Ujit,

VENDOSI:

1. Refuzimin e kërkesës për leje për përdorim të burimit ujor sipërfaqësor për turizëm, argëtim, lundrim, subjekti “ST.LUIS WATERSPORT” shpk, me vendndodhje deti Adriatik, plazhi Rrashbullit, bashkia Durrës.
2. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI

AFRIM QËNDRO

